



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.103

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 14 nëntor 2024, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj, dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Mungoi: Floretë Zejnullahu, anëtare.

Stafi mbështetës : Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

Pjesëmarrës tjerë: Violeta Salihu – Emini nga KSHMS-ja .

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 24.9.2024, 4.10.2024 dhe 5.11.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit;
4. Të ndryshme.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 24.9.2024, 4.10.2024 dhe 5.11.2024

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24.9.2024, 4.10.2024 dhe 5.11.2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit

Fatmire Kollçaku, tha se Komisioni, në bazë të Rregullores së Kuvendit, e shqyrton këtë projektligj, nëse ka ndonjë rekomandim ose amendament. Lidhur me këtë, njoftoi se Komisioni, deri më tani, nuk ka pranuar asnjë propozim-amendament nga institucionet përkatëse, të cilat janë në fushëveprim të Komisionit.

Bekim Haxhiu, sa i përket sektorit të shëndetësisë, me këtë projektligj prej 161 milionë eurosh të planifikuara nga MSH-ja, vetëm 990 mijë euro janë të destinuara për projekte të reja, nuk mund të reformohet sektori i shëndetësisë, përderisa nuk i jepet prioritet në shumë drejtime për ta zhvilluar sistemin shëndetësor, prandaj ky projektligj tregon dështimin katërvjeçar të kësaj qeverie, kur miratohet edhe buxheti i pestë nga kjo qeveri. Këto pesë buxhete miratohen pa pasur një strategji të shëndetësisë. Nuk ka funksionalizim të SISH-it (Sistem Informativ Shëndetësor), nuk ka sigurime shëndetësore. Si mund ta reformojmë sektorin e shëndetësisë, kur për projekte të reja janë paraparë nga buxheti vetëm 990 mijë euro? Kur nuk trajtohen problemet e punëtorëve shëndetësorë, siç janë infermierët, stafit mbështetës dhe të punëtorëve teknikë, që me Ligjin për pagat e sektorit publik, kanë mbetur me koeficient shumë të ulët për punën dhe angazhimet që i kanë.

Shemsedin Dreshaj, tha se mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit, sa i përket buxhetit të paraparë për fushën e shëndetësisë për vitin 2025, gjendja në këtë sektor nuk do të përmirësohet. Dhe ky buxhet është i varfërisë në veçanti për shëndetësi dhe arsim. A mund të presim përmirësim të gjendjes së shëndetësisë? Ju them që jo. Secila prej shteteve të rajonit, dyfishin e GDP-së (Bruto Produkti Vendor) kanë të ndarë për shëndetësi. Mos të flasim për pakënaqësitë e mjekëve, ikjen e stafit shëndetësor nga sektori publik në privat e jashtë vendit. Ky buxhet është dashur të adresojë problemet e evidentuara deri më sot, sepse shëndetësia duhet të jetë prioritet i këtij vendi. Ndërsa, sigurimet shëndetësore as nuk janë të parapara. Pagesat për trajtimin e pacientëve jashtë vendit, janë mbartur prej vitit në vit dhe me këtë Projektligji mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, shëndetësia vazhdon të mbetet aty ku është. Ky buxhetit është i pamjaftueshëm dhe së paku është dashur të bëhet dyfishim i buxhetit për shëndetësi dhe arsim.

Haxhi Avdyli, sa i përket sektorit të mirëqenies sociale, që janë në fushëveprim të Komisionit, tha se buxheti i vitit 2025, është i shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe do të ndihmojë në zbutjen e shkallës së varfërisë në Kosovë. Ky buxhet ka adresuar të gjitha kërkesat e qytetarëve, veçanërisht në skemën e mirëqenies sociale. Rritjet që janë paraparë në paga, pensione, përkrahja ndaj lehonave, fëmijëve e kategorive të ndryshme të anashkaluar, këto ndarje buxhetore kanë ndikuar në zbutjen e hendekut në të hyrat familjare, ku ka pasur përkrahje të drejtpërdrejtë me anë të subvencioneve dhe këto veprime janë për t'u përhëndetur. Kjo do të përmirësojë gjendjen e familjeve dhe do të rrisë fuqinë blerëse me anë të këtyre masave buxhetore. Ndërsa, lidhur me investimet kapitale në sektorin e shëndetësisë, tha se ka investime të shumta, sidomos nëpër klinikat e QKUK-së, duke filluar nga renovimet e infrastrukturës së tërësishme, blerjes së aparaturave nga teknologjia më e fundit që janë në treg për nevojat e shërbimeve mjekësore. Lista esenciale e barnave është përmirësuar, kemi rritje të buxhetit prej 35 milionë euro, sa ishte tash është rritur në 60 milionë euro. Është rritur gama e shërbimeve shëndetësore, duke u rritur edhe numri i operacioneve mjekësore, pas zgjerimit të rritjes së këtyre shërbimeve, janë zvogëluar edhe kërkesat për trajtim të pacientëve jashtë vendit.

Shemsedin Dreshaj, tha se ne duhet t'i shohim gjërat në mënyrë konkrete, nga ndarjet buxhetore, për shëndetësi që është buxheti më i ulët në rajon, në raport me BPV. Ky buxhet nuk i adreson problemet e shoqërisë kosovare. Me këtë buxhet, Kosova do të jetë vendi me paga më të ulëta në rajon për punëtorët shëndetësorë, nuk do të ketë sigurime shëndetësore, do të vazhdojë lista e pritjeve për shërbime shëndetësore, nuk do të zgjidhet ikja e punëtoreve shëndetësorë jashtë vendit. Përderisa 3.4 të Bruto Produktit Vendor, e kemi të dedikuar për shëndetësi, si mund t'i përmirësojmë shërbimet mjekësore, ikja profesionistëve shëndetësorë nga vendi, duke filluar nga infermierët, mjekët dhe moszbatimi i sigurimeve shëndetësore. Këto janë vetëm disa prej problemeve që do t'i trashëgojmë edhe gjatë vitit 2025, andaj kjo ndarje buxhetore për shëndetësinë që nuk është e mjaftueshme, nuk mund të rritet cilësia e shërbimeve mjekësore.

Haxhi Avdyli, tha se sa i përket çështjes së ikjes së mjekëve, gati po bëhen dy vite pas miratimit të Ligjit për pagat në sektorin publik, kemi rritje 100% të rrogave për mjekët, dhe pagat e punëtorëve shëndetësorë, gjatë Qeverisë Kurti, janë rritur si asnjë herë tjetër, sidomos nëse bëhet fjalë për pagat e mjekëve, të cilat ishin 600 euro, ndërsa tani janë 1200 euro, duke shtuar më pas edhe pagesat e kujdestarive, të cilat janë mjaft të larta dhe nuk mund të mos sqarohet kjo edhe para opinionit të gjerë publik. Për sigurimet shëndetësore jam optimist, pasi gjithë këtyre investimeve, qoftë në infrastrukturë, në blerjen e aparaturave mjekësore, në rritjen e gamës së shërbimeve mjekësore, tash që janë bërë, rritja e standardit të përgjithshëm të jetesës në vend dhe te GDP-së, janë krijuar parakushte për fillimin e krijimit të fondit të sigurimeve shëndetësore.

Bekim Haxhiu, tha se sa i përket se rritjes së pagave nga 360 në 600 euro, për herë të parë janë rritur nga Qeveria Thaçi, ndërsa tash në Qeverinë e Kurtit, hendeku në mospagesë të mjekut dhe infermierit është i lartë. Ndërsa, lidhur investimet kapitale, që po mundoheni t'i paraqiti si të arritura dhe të suksesshme, në këto investime e kam thënë disa herë dhe vazhdoje ta përsëris se janë bërë keqpërdorime milionëshe në rinovimeve të klinikave të QKUK-së dhe në blerje të aparaturave. Për vlerat e renovimeve të klinikave të QKUK-së, kemi të bëjmë me zhvatje të buxhetit dhe konflikt të interesit, ku kompania që e ka fituar tenderin, ka përfituar shumë më shtrenjtë nga çmimi real i tregut, për shembull, heqja e një tepisoni në Klinikën e Gjinekologjisë ka kushtuar 33 euro, ndërsa heqja e saj në çmimin e tregut është 1 euro, heqja e dyerve ka kushtuar 58 euro, ndërsa në çmimin e tregut është 10 euro.

Mirsad Shkreta, kërkoi që të fokusohemi te pika e rendit të ditës, që është shqyrtimi i Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit. Pajtohemi që buxheti në raport me GDP-në, nuk është i mjaftueshëm, por është ndarje më e madhe sa i përket banave esenciale, sepse aty shkon buxheti më i madh që ishte dashur qytetaret t'i paguanin nga buxheti i tyre financiar. Po ashtu, me këtë ndarje buxhetore pritet të rriten të gjitha fushat në shërbimet mjekësore. Numri i pacientëve që po trajtohen dhe operohen nëpër klinikat e kirurgjisë brenda QKUK-së, është rritur, falë investimeve kapitale që janë rritur në infrastrukturë dhe në blerje të aparaturave të reja. Është rritur edhe numri i pacientëve në mënyrë progresive prej vitit 2022- 2024, që po i marrin shërbimet në rezonancat magnetike dhe CT. Në shumë drejtime, duhet edhe më tutje t'i rrisim shërbimet dhe cilësinë. Për fondin për trajtim jashtë vendit, ka buxhet të paraparë për pagesa. Fakti që janë rritur ato shërbime që i ceka më lart, është ulur numri i pacientëve që kërkojnë trajtim jashtë vendit. Me këto veprime, për herë të parë, po dëshmohet se shëndetësia është prioritet i kësaj Qeverie.

Armend Zemaj, tha se kur po shqyrtojmë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, mos na gjykoni se kinse na opozita nuk po ju gëzohemi arritjeve, por fatkeqësisht kjo Qeveri, me këtë mandat të qeverisjes, nuk është marrë me shëndetësi në mënyrë përmbajtjesore, por për 4 vite të qeverisjes ka improvizuar, për vet faktin që katër ministra i ka ndërruar dhe Qeveria, me vendim, e ka themeluar Komisionin Ekzekutiv për

Shëndetësi, që Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti, është kryesues i këtij komisioni ekzekutiv. Sa përket projekteve kapitale të Ministrisë së Shëndetësisë, që janë në Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, 70% e buxhetit është nga viti në vit, nuk ka rritje të buxhetit, këto janë bartje, dhe kjo është dëshmi, shikoni për vitin 2025, të gjitha projektet kanë kosto 0 (zero), i keni në tabelë buxhetore: Programet mbështetëse të sistemit shëndetësor; Projekti për përforcimin e sistemit shëndetësor, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK); dhe Shërbimet rajonale të kujdesit dytësor shëndetësor, janë si në vijim: Zgjerimi hapësirave të Shërbimit të Radiologjisë, me destinim për vendosje të CT skanerit të ri dhe rezonancën magnetike; ndërtimi i objektit të depos qendrore të barnave; QKUK-shërbimi terciar shëndetësor; infrastruktura tjetër dhe renovimi i nyjave sanitare për të gjitha klinikat; termoizolimi dhe fasadimi i objekteve; infrastruktura në rregullimin e ambientit; pajisje mjekësore për nevoja të programeve buxhetore të SHSKUK-së; modernizimi i infrastrukturës të objekteve spitalore të programeve buxhetore të SHSKUK-së; ndërtimi i objektit për Klinikën Hemato-Onkologjike; projektimi dhe ndërtimi i ndërtesës së re të Klinikës së Nefrologjisë. QSKUK-shërbimi terciar shëndetësor: pajisje mjekësore për repartet e spitaleve rajonale; ndërtimi i ndërtesës së re të QSKUK-së; ndërtimi i objektit për nëna dhe fëmijë, i kompletuar me pajisje përcjellëse për spitalin e Prizrenit; modernizimi i infrastrukturës së njësive përbërëse të SHSKUK-së; blerja e pajisjes mjekësore për njësitë përbërëse të SHSKUK-së; shëndetësia sekondare.

Blerja e pajisjeve të specializuara; gastroskopi, kolonoskopi, pajisjet EKG, aspirator, defibrilator, sterilizues, video-sistem, termokauter, si dhe pajisje për operimin e katarakt. Pajisje ndihmëse për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Furnizimi me aparaturë stomatologjike; furnizimi me aparatura laboratorike; shërbimet e shëndetësisë primare: autoambulanca për nevoja të QKMF-së; blerja e autoambulancës me pajisjet përcjellëse mjekësore; ndërtimi i qendrës rehabilituese për përdoruesit e substancave narkotike në Ferizaj; ndërtimi i ri i QKMF-së në Ferizaj; blerja e dy autoambulancave për nevojat e QKMF në Ferizaj dhe rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit, e shumë të tjera, që për shkak të kohës nuk po e i cekim, të gjitha kanë vetëm 0 zero euro buxhet në vitin 2025. Ai tha se edhe të shëndetësia primare, dytësore dhe terciare, janë të evidentuara qindra projekte që kanë buxhet 0 (zero) për vitin 2025. Këto të dhëna i gjen të gjitha në tabelën e projektligjit. Andaj, qeveria, gjatë vitit të ardhshëm nuk ka paraparë projekte të reja që do të përmirësonin gjendjen në shëndetësinë e vendit.

Fatmire Kollçaku, lidhur me investimet në projektet kapitale, tha se e rëndësishme është që të kryhen projektet që janë nisur. Ajo shtoi se në QKUK dhe në spitale rajonale, është bërë transformim gjatë qeverisjes Kurti, andaj duhet të vendoset një logjikë që qeveritë të vazhdojnë t'i kryejnë projektet e filluara. Nëse keni menduar që ne duhet të bëjmë investime kapitale të reja, ne e kemi synim t'i kryejmë ato që kanë nisur. Kemi rritje të buxhetit, rritje për listën esenciale, rritje për fondin për trajtim jashtë vendit. Kushdo që e frekuenton QKUK-në dhe spitalet rajonale, e vërejnë transformimin që është bërë në infrastrukturë dhe në blerje të aparaturave të reja mjekësore dhe këto projekte që janë filluar, duhet të kryhen.

Bekim Haxhiu, siç e dini, për çdo vit buxhetor për këto 4 vite të kësaj qeverisje, kam propozuar amendamente në të mirë të shëndetësisë së vendit, por asnjëherë, asnjë amendament që e kam propozuar nuk janë marrë për bazë dhe nuk më janë miratuar, andaj kësaj here kam vendosur që mos të bëjë propozim-amendamente, për faktin që nuk po gjej përkrahje nga shumica parlamentare, që është mazhoranca.

Mirsad Shkreta, për hir të opinionit publik, duhet të përmenden të arriturat e kësaj Qeverie në fushën e shëndetësisë, sepse janë evidente, si: rritja e pagave të mjekëve, plus pagesat e kujdestarisë, përmirësimi i kushteve të punës si nga aspekti teknik, ashtu edhe infrastrukturor, rritja e gamës së shërbimeve, realizim enorm të stendimeve në Klinikën e Kardiokirurgjisë, ku deri më tani, pacientët janë referuar për trajtim jashtë institucioneve publike, lista esenciale e barnave e

përbushur mbi 90%, reduktim të listave të pritjes, ndarje të specializimeve sipas nevojave dhe shumë e shumë punë të tjera, të cilat tani shëndetësinë tonë e bëjnë të krahasueshme edhe me vendet e rajonit.

Burim Meta, tha se në aspektin buxhetor për shëndetësi, Qeveria aktuale ka bërë më shumë sesa qeveritë tjera, mirëpo prapëseprapë është nevoja që të bëhet edhe më shumë për aq sa ka buxhet, sidomos për furnizim edhe për disa barna, që duhet të futen në listën esenciale të barnave. Prandaj, edhe për këtë arsye, i kam dorëzuar 7 amendamente, prej të cilave 2 kanë të bëjnë me shëndetësi dhe 5 të tjerat me mirëqenien sociale. Arsyetja për këtë qëndron në rritjen e buxhetit për barnat e listës esenciale dhe planifikimet për një trajtim më të dinjitetshëm për personat që trajtohen në qendrat e shëndetit mendor. Kërkoi mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit në seancën e Kuvendit, në lexim të dytë, kur të shqyrtohet Projektligji mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, për votimin e këtyre amendamenteve, që i ka propozuar.

Fatmire Kollçaku, tha se shumica e diskutimeve janë jashtë rendit të ditës, ndërsa nuk kemi të propozuar asnjë amendament dhe kërkoi që të votohet Projektligji mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit.

Komisioni, pas debatit, me 6 (gjashtë) vota për, vendosi:

Ta njoftojë Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, se nuk ka rekomandime e as amendamente për Projektligjin nr.08/L-332, mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit.

3.Të ndryshme

Bekim Haxhiu kërkoi që të shqyrtohet draft-raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë, pasi që ka përfunduar procesi i monitorimit të këtij ligj.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisioni
